

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-069/13

**Prishtinë,
18 Nentor 2014**

Në çështjen juridike të:

Sh. A.

Duboc

Pala ankuese

Kundër

B. R.

Prishtinë

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët, Esma Erterzi, Kryetare e Kolegjit, Willem Brouwer, dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/157/2012, të datës 06 qershor 2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin 13046), pas shqyrtimit të mbajtur më 18 Nentor 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Hidhet poshtë si e papranueshme ankesa e z. Sh. A. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/157/2012 (lënda e regjistruar në KPA me nr.KPA13046/13) të datës 06 qershor 2012.

Përmbledhja e çështjeve faktike dhe procedurale:

1. Më 11 korrik 2006, paraqitësi i kërkesës B. R. ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar ri-posedimin e një shtëpie prej 120 m², që ndodhet në ngastrën nr. 1200 me sipërfaqe prej 11 ari e 58 m² në Zonën Kadastrale të Matiçanit, Komuna e Prishtinës. Kërkesa ishte regjistruar në AKP me numrin KPA13046.
2. Për të mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesës, z. B. R., ka dorëzuar në AKP dokumentet në vijim:
 - Fletën poseduese nr. 43 të lëshuar nga Drejtorati për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë i Prishtinës më 10 prill 2001, e cila tregon se ngastra e kërkuar nr. 1200 dhe ajo 1199/2 janë të regjistruara në emër të B. R.;
 - Kopjen e planit të lëshuar nga Komuna e Prishtinës të datës 11 prill 2001;
 - Kopjen e letërnjoftimit të B. R.;
3. Fleta poseduese në fjalë ishte verifikuar pozitivisht nga AKP-ja.
4. Njoftimi fizik i pronës në mosmarrëveshje në lëndën KPA13046, që do të thotë nr. 1200, ishte bërë së pari më 11 gusht 2006. Raporti i njoftimit i të njëjtës datë në lidhje me ngastrën nr. 1200 nxjerrë në pah se prona ishte uzurpuar nga z. Sh. A., i cili ishte i pranishëm personalisht gjatë procesit të njoftimit. Ai ka deklaruar se pronën po e shfrytëzonte vetëm për qëllime të banimit dhe nuk ka kërkuar ndonjë të drejtë ligjore mbi pronën e kërkuar. Ai më tej ka deklaruar se nuk ka dashur që të paraqes kërkesë në AKP.
5. Në shkresat e lëndës po ashtu gjendet edhe një deklaratë e nënshkruar nga pala përgjegjëse në kërkesë, z. Sh. A., për një pronë tjetër (ngastra nr. 1199 në Matiçan të Prishtinës) ku në njërën anë theksohet se ai dëshiron të marrë pjesë në procedurën pranë AKP-së dhe KKPK-së, e që mban

datën e 8 nëntorit 2006, ndërsa në anën tjetër ceket se ai deklaroi se e ka shfrytëzuar pronën e kërkuar vetëm për qëllime të banimit dhe se nuk pretendon ndonjë të drejtë ligjor mbi pronën e kërkuar (ngastra nr.1199 në Matičan, Prishtinë), por se ai nuk ka ndonjë strehim tjetër, që mban datën e 6 dhjetorit 2006. Gjykata Supreme vëren se ngastra nr. 1199 (përkundër faktit se fleta poseduese nr. 43 i referohet po kësaj ngastre) nuk është kërkuar në lëndën nr.KPA13046 e cila mbulon vetëm ngastrën nr. 1200.

6. Më 21 prill 2010, është bërë ri-njoftimi i pronës. Njoftimi i pronës është bërë si duhet në bazë koordinatave të GPS-it dhe orto-fotografive. Znj. F. A. ishte e pranishme gjatë njoftimit dhe ka deklaruar se nuk kërkon ndonjë të drejtë pronësore, interes apo leje për të shfrytëzuar apo për tu vendosur në pronën e kërkuar (ngastra nr. 1200). Ajo ka nënshkruar njoftimin e kërkesë më 21 prill 2010 dhe ka deklaruar se do ta vizitonte AKP-në sa më parë që të jetë e mundur.
7. Kërkesa kishte qenë e pakontestuar gjatë procedurës në shkallë të parë për faktin se personat që e shfrytëzonin pronën në kohën e njoftimit nuk e kishin kontestuar kërkesën brenda afatit prej 30 ditëve të paraparë me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079
8. KKPK-ja e ka miratuar kërkesën me vendimin KPPC/D/R/157/2012 të datës 06 qershor 2012.
9. Më 08 shkurt 2013, vendimi i është dorëzuar Sh. A. (tani e më tej: pala ankuese). Ai ka paraqitur ankesë kundër vendimit në fjalë të KKPK-së më 04 mars 2013. Së bashku me ankesën, pala ankuese ka paraqitur dokumentet (kopje) e mëposhtme si prova:
 - Kopjen e letërnjoftimit të Sh. A.
 - Kërkesën e paraqitur nga V. A., të datës 20 prill 2012, për rishikim të vendimit për njohjen e së drejtës pronësore në lëndën e AKP-së nr.13057.

12. Ankesa i është dorëzuar B. R. më 16 gusht 2013. Ai ka paraqitur përgjigje në ankesë më 29 gusht 2013.

Pretendimet e palëve:

13. Paraqitësi i kërkesës, z. B. R., në kërkesën e tij pohon se prona ishte humbur si rezultat i konfliktit të armatosur në Kosovë në vitet 1998/1999 dhe se ajo është uzurpuar. Data e specifikuar e humbjes është 24 qershor 1999. Në përgjigjen e tij në ankesë, ai pohon se asnjëherë nuk e kishte shitur pronën e tij

gjatë periudhës së përmendur nga pala ankues, sepse ai nuk kishte qenë në Kosovë. Ai më tej deklaroi se ai është pronar që paguan taksat mbi pronën, siç janë obligimet tatimore, tatimin në pronë, etj.

14. Pala ankuese, z. Sh. A., pretendon se vendimi i AKP-së në lëndën KPA 13046 është marrë me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Përkundër faktit se ankesa e tij ka të bëjë me lëndën nr. KPA 13046, përmbajtja e ankesës i referohet kërkesës së tyre të datës 20 prill 2012 për rishikim të vendimit të KKPK-së (pa dhënë ndonjë numër). Ajo kërkesë e datës 20 prill 2012, e paraqitur nga V. A., e që është e bashkëngjitur me ankesën, flet për lëndën nr. KPA 13057 dhe ka të bëjë me vendimin e KKPK-së të datës 29 mars 2012 lidhur me ngastrën nr. 1199/2. V. A., afërsia familjare e të cilit më Sh. A. është e panjohur për gjykatën, në atë kërkesë kërkon të drejtën ligjor vetëm mbi sipërfaqen prej 2.5 ari ku ndodhet shtëpia, e jo mbi tërë ngastrën nr. 1199/2. Sh. A., pala ankuese, sqaron se KKPK-ja nuk e ka marrë parasysh kërkesën e datës 20 prill 2012 dhe se vendimi ishte marrë për 11.58 ari që nuk përputhet me objektin e kontestuar dhe me kërkesën e tij.

15. Pala ankuese pohon se sa i përket sipërfaqes prej 2.5 ari së bashku me shtëpinë, ai kishte lidhur marrëveshje gojore me B. R. në nëntor të vitit 1999 dhe pagesa në shumën prej 15 000 markave gjermane ishte kryer për shitjen e shtëpisë në prani të 5 (pesë) dëshmitarëve. Ai po ashtu deklaroi se deklaratat e tij iu ishin dhënë zyrtarëve të AKP-së gjatë vizitave të tyre.

Arsyetim ligjor:

Juridiksioni

19. Gjykata Supreme ka juridiksion për të shqyrtuar ankesën.

Pranueshmëria e ankesës

21. Ankesa e z. Sh. A. është e papranueshme, pasi ai nuk ka qenë palë në procedurën në shkallë të parë pranë KKPK-së.

22. Sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji nr. 03/L-079), pala mund të paraqesë ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftim i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës me vendimin e Komisionit për Kërkesa Pronësore.

23. Neni 10.1 i Ligjit. 03/L-079 parasheh që pas pranimit të kërkesës, Sekretaria ekzekutive e njofton dhe i dërgon nga një kopje të kërkesës çdo personi, përpos paditësit, i cili aktualisht ushtron apo pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës. Neni 10.2 i po të njëjtit ligj thekson se *“çdo person, përveç paditësit, i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës ose çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në pronën ndaj së cilës është parashtruar kërkesë është palë ... me kusht që personi i tillë ta informojë Sekretarinë Ekzekutive për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi për kërkesën nga Sekretaria Ekzekutive [...]”*.

24. Vetëm pala në procedurën në shkallë të parë ka të drejtë të paraqes ankesë kundër vendimit të KKPK-së. Sipas juridiksionit të Kolegjit të AKP-së të Gjykatës Supreme, përjashtimi i vetëm nga kjo rregull vjen në pah vetëm nëse dhe kur personi që mund të pretendojnë një të drejtë mbi pronën e kontestuar nuk ka qenë në dijeni për kërkesën e paraqitur në AKP për shkak të mungesës së njoftimit të duhur dhe në këtë mënyrë nuk është në gjendje që të paraqes njoftimin për pjesëmarrjen.

25. Në rastin konkret, Gjykata Supreme vëren se pala ankuese ishte në dijeni të procedurës në lëndën nr. KPA 13046 pasi që ai është njoftuar personalisht më 11 gusht 2006. Megjithatë, ai nuk ka kërkuar ndonjë të drejtë ligjore mbi ngastrën nr. 1200 e cila është çështje lëndore e kërkesës në këtë rast. Ai nuk e ka paraqitur as njoftimin për pjesëmarrje siç kërkohet me nenin 10.2 të Ligjit nr. 03/L-079. Gjykata Supreme gjen se njoftimi ishte bërë në mënyrën e duhur. Pala ankuese, gjatë njoftimit shprehimisht ka deklaruar se nuk kërkonte ndonjë të drejtë ligjor, interes apo leje për shfrytëzuar apo për tu vendosur në pronën e kërkuar (ngastrën nr.1200). Pala ankuese nuk ka dhënë arsye ligjërisht të vlefshme, të arsyeshme dhe të justifikuar për ta informuar AKP-në për qëllimin e tij për të marrë pjesë në procedurë, gjë që ai domosdoshmërisht është dashur ta bënte. Pasi që nuk ka arsyetim se përse ai nuk ka marrë pjesë në procedurën në shkallë të parë pranë AKP-së, një lëshim i tillë shkon në dëm të tij.

23. Gjykata Supreme e konsideron të dobishme të theksohet se çështja lëndore e kërkesës nr. KPA 13046, e përmbyllur me vendimin KPPC/D/R/157/2012 ka të bëjë me një objekt banimi me sipërfaqe prej 120 m², e ndërtuar në ngastrën nr.1200. Pretendimet e palës ankuese për njohjen të drejtës pronësore mbi shtëpinë së bashku me 2.5 ari që ndodhen në ngastrën nr.1199/2 nuk janë çështje lëndore e këtij shqyrtimi. Ankesa e tij e atakon një vendim tjetër të KKPK-së të datës 29 mars 2012 e jo vendimin KPPC/D/R/157/2012. Duke qenë se ankesa është e papranueshme, Gjykatës Supreme nuk i duhet të vendos për meritat e ankesë.

24. Ankesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme në përputhje me nenin 12.1 dhe 13.3 (b) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 195.1 nën-paragrafin (a) të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore. Prandaj, Kolegji vendosi së në dispozitiv.

Këshillë juridike

25. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Esma Erterzi, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Nënshkruar nga: Urs Nufer, Referent i EULEX-it